



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT  
KËSHILLI I BASENIT UJORË MAT

Vendim

Nr. 12 datë 26/07/2018

“Për

miratimin e lejes për përdorim burimi ujqor, për prodhim hidroenergjie, për hec “SANG”, me vendndodhje: përroi i Thirrës dhe Hebjes, degë e lumit Fan i Vogël, degë e Lumi Mat në Njësinë Administrative Fan, Bashkia Mirditë, Qarku Lezhë, Subjektit “SANG 1” sh.p.k”.

- Në mbështetje të nenit 7 pika 2, nenit 51 dhe nenit 52 të ligjit nr 111/2012 dt.15.11.2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujqore” të ndryshuar, vendimin nr.416 datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kushteve të përgjithshme dhe të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe Leje për përdorim të burimeve ujqore”, nenit 24 të Vendimit të KM nr. 822, date 07.10.2015, “Per miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt konçesioni”, **si dhe miratimit paraprak nr. 4244/1 datë 01/06/2017 të Ministrisë të Energjisë dhe Industrisë, miratimin në parim nga KBU Mat me nr. 14 dt. 22.02.2017**, me propozim të A.B.U. Mat, Këshilli i Basenit Ujqor Mat;

Vendos i:

1- Miratimin e “Lejes për Përdorim të Rezervave Ujqore për prodhimin e energjisë elektrike”, Subjektit “SANG I” sh.p.k, me Administrator Z.Lek Përnoça, me këto të dhëna:

- përroi i Thirrës dhe Hebjes, degë e lumit Fan i Vogël, degë e Lumi Mat, në Njësinë Administrative Fan, Bashkia Mirditë, Qarku Lezhë, Subjektit “SANG 1” sh.p.k”, **Hec “SANG”**

	Përroi i Thirrës	Përroi i Hebjes
-Prurja mesatare :	$Q_{mes} = 1.14 \text{ m}^3/\text{sek}$ ,	$Q_{mes} = 0.38 \text{ m}^3/\text{sek}$ ,
-Prurja llogarites:	$Q_{llog} = 1.9 \text{ m}^3/\text{sek}$ ,	$Q_{llog} = 0.7 \text{ m}^3/\text{sek}$ ,
-Prurja ekologjike:	$Q_{ekol} = 0.078 \text{ m}^3/\text{sek}$	$Q_{ekol} = 0.026 \text{ m}^3/\text{sek}$ ,
-Kuota e vepres së marrjes 1	Z= 675 m	X- 44 34 850
Kuota e vepres së marrjes 2	Z= 675 m	X- 44 32 336
-Kuota e godines se centralit:	Z = 586 m	X- 44 33 205
		Y- 46 51 470
		Y- 46 50 777
		Y- 46 49 553

- Fuqia 1790kë/ore  
-Energjia e planifikuar vjetore: 5 219 323 këh/vit,

2- Nuk lejohet ndryshimi i regjimit të vaditjes, i furnizimit me ujë të popullatës etjerë nga përdorimi i ujit për energji elektrike.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

PËRGJEGJËSI I A.B.U. MAT  
Bujar SHPENDI



KRYETARI I K.B.U. MAT  
Gjergj PRENDI

